

**MARRËVESHJA MBI OFRIMIN E NDËRSJELLË TËTRUALLIT
DHE AMBIENTEVE TË AMBASADAVE
NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS
DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Qeveria e Republikës Popullore të Kinës (më tej referuar si pala kineze) dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (më tej referuar si pala shqiptare) (më tej referuar si dy palë);

Me qëllim për të siguruar kushte pune dhe jetese të përshtatshme për Ambasadën e Republikës Popullore të Kinës në Republikën e Shqipërisë dhe Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Republikën Popullore të Kinës dhe;

Mbi bazën e përfitimit dhe reciprocitetit të ndërsjellë, kanë arritur marrëveshjen e mëposhtme përmes konsultimeve miqësore:

Neni 1

1. Pala kineze do t'i ofrojë palës shqiptare përdorimin e ambienteve në Nr.28 Rruga Guanghai, Qarku Chaoyang, Pekin (që mbulojnë një sipërfaqe toke prej 9,300 metra katrorë dhe një sipërfaqe ndërtimi prej 3,466 metra katrorë) pa pagesë. Pala shqiptare mund ta përdorë atë si Kancelari të Ambasadës, rezidencë zyrtare të ambasadorit dhe banesa për personelin e ambasadës dhe ambiente ndihmëse. Harta e ndërtesës dhe tokës që ajo zë është bashkangjitur si shtojca I dhe pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

2. Pala shqiptare duhet t'i sigurojë palës kineze përdorimin e ambienteve në Rr. Skënderbej 57, Tiranë (që mbulojnë një sipërfaqe toke prej 4,624 metra katrorë dhe sipërfaqe ndërtimi prej 3,948 metra katrorë) pa pagesë. Pala kineze mund të përdorë atë si Kancelari të Ambasadës, rezidencë zyrtare të ambasadorit dhe banesa për personelin e ambasadës dhe ambiente ndihmëse. Harta e ndërtesës dhe e tokës që ajo zë është bashkangjitur si Shtojca II dhe pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

3. Pala shqiptare do t'i ofrojë palës kineze përdorimin e tokës në "Ish-Oficina e automjeteve Tirana, NSHRAK", zona kadastrale 8250, Tiranë që mbulon një sipërfaqe prej 9000 metra katrore pa pagesë. Pala kineze mund të ndërtojë mbi këtë tokë kancelarinë e Ambasadës, rezidencën zyrtare të ambasadorit dhe banesat e personelit të ambasadës dhe ambiente ndihmëse.

Harta e tokës është bashkangjitur si Shtojca III dhe pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

1. Pala kineze do të garantojë që nuk ka mosmarrëveshje lidhur me detyrime ose pronësinë mbi ndërtesën dhe truallin që ajo zë të përmendur në paragrafin 1 të Nenit 1. Nëse ndodh ndonjë mosmarrëveshje e tillë, ajo do të zgjidhet nga pala kineze.

2. Ndërtesa e sipërpërmendur dhe trualli që ajo zë dhënë nga pala kineze janë të furnizuara me ujë, energji elektrike, gaz, ngrohje, komunikim dhe lehtësira të tjera dhe janë të gatshme dhe të sigurta për t'u përdorur.

3. Pala shqiptare mund të riparojë, rindërtojë, apo të zgjerojë ndërtimin e sipërpërmendur me shpenzimet e veta. Çdo plan rikonstruksioni ose zgjerimi duhet të miratohet me pëlqimin paraprak me shkrim nga pala kineze.

Neni 3

1. Pala shqiptare do të garantojë që nuk ka mosmarrëveshje lidhur me detyrime ose pronësinë mbi ndërtesën dhe truallin që ajo zë të përmendur në paragrafin 2 dhe paragrafin 3 të Nenit 1. Nëse ndodh ndonjë mosmarrëveshje e tillë, ajo do të zgjidhet nga pala shqiptare.

2. Ndërtesa dhe trualli që ajo zë dhënë nga pala shqiptare e përmendur në paragrafin 2 të Nenit 1 janë të pajisura me ujë, energji elektrike, gaz, ngrohje, komunikim dhe lehtësira të tjera dhe janë të gatshme dhe të sigurta për t'u përdorur.

3. Pala kineze mund të riparojë, rindërtojë ose zgjerojë godinën e referuar në paragrafin 2 të Nenit 1 me shpenzimet e saj. Çdo plan për rikonstruksionin ose zgjerimin duhet të miratohen me pëlqimin paraprak me shkrim nga pala shqiptare.

4. Pas transferimit të tokës së përmendur në paragrafin 3 të Nenit 1, nuk do të ketë asnjë ndërtim, pajisje ose tubacion mbi ose nën tokë, do të ketë rrugë komunale deri në kufijtë e tokës dhe pala shqiptare duhet të sigurojë me shpenzimet e saj që të ketë tubacione uji, energjie elektrike, gazi, ngrohje dhe komunikimi deri në kufijtë e tokës siç kërkohet nga projekti i ndërtimit. Pala shqiptare do të përfundojë këtë punë përgatitore të tokës dhe transferimin e tokës palës kineze brenda 12 muajsh të hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

5. Pronësia e objekteve që do të ndërtohen nga pala kineze mbi truallin e përmendur në paragrafin 3 të Nenit 1 i përket palës kineze. Pas përfundimit të projektit të ndërtimit, pala shqiptare do të ndihmojë palën kineze për përfundimin e procedurave përkatëse të regjistrimit të pronësisë. Pronësia mbi truallin i mbetet palës shqiptare.

Neni 4

1. Nëse secila palë synon të ndërtojë, riparojë ose zgjerojë ndërtesat, ajo duhet t'i përmbahet ligjeve, rregulloreve dhe kërkesave vendase të projektimit dhe të kalojnë paraprakisht nëpër procedurat e miratimit.

2. Të dy palët mund të zgjedhin lirisht kompani nga vendi i tyre ose nga vendi pritës për të projektuar, ndërtuar dhe mbikëqyrur projektin e mësipërm.

3. Të dy palët bien dakord për të ofruar lehtësira dhe ndihmë njëra-tjetrës në projektimin dhe miratimin e ndërtimit, transportin e materialeve dhe të pajisjeve, dhe lejet e hyrjes dhe qëndrimit të punëtorëve për ndërtimet e lartpërmendura.

4. Në përputhje me parimin e reciprocitetit, ambientet e parashikuara në nenin 1 do të mirëmbahen dhe riparohen nga përdoruesi. Të gjitha shpenzimet që rrjedhin prej tyre do të ngarkohen përdoruesit të ambienteve.

Neni 5

Ndërtesa dhe toka të referuara në Nenin I, do të përdoren ekskluzivisht për qëllime të ambienteve e shërbimeve diplomatike dhe konsullore dhe banesat e personelit diplomatik.

Neni 6

Të dy palët do të përjashtojnë njëra-tjetrën nga të gjitha taksat dhe tarifatat mbi ndërtesat dhe tokën të referuara në Nenin I, në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplommatike dhe parimin e reciprocitetit, me përjashtim të pagesave për shërbimet. Çështjet specifike në lidhje me përjashtimin do të trajtohen në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse të vendit pritës.

Neni 7

Ndryshime dhe plotësime mund t'i bëhen kësaj Marrëveshjeje me pëlqimin e të dy palëve. Çdo ndryshim ose shtesë e kësaj marrëveshjeje do të bëhet në formën e një protokolli që do të jetë pjesë integrale e kësaj marrëveshjeje.

Neni 8

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi nga data e nënshkrimit të saj dhe do të mbetet e vlefshme për 70 vjet.

2. Të dy palët do të zhvillojnë konsultime mbi zgjatjen e kësaj Marrëveshjeje një vit para skadimit të saj.

Neni 9


Marrëveshja reciproke mbi Ambasadën në mes Ambasadës së Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, më 1 prill 1960, në formën e shkëmbimit të notave do të përfundojë në ditën kur kjo Marrëveshje hyn në fuqi.

Neni 10

Në rast të ndonjë mospërputhjeje në interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, të dy palët duhet të kërkojnë zgjidhje përmes konsultimeve miqësore.

Hartuar në dy kopje në Pekin më 8 / 25 / 2016 në gjuhën kineze, gjuhën shqipedhe angleze, të gjitha tekstet duke qenë njëloj autentike. Në rast të mospërputhjeve në interpretimin e tekstit, përparësi do të ketë teksti në gjuhën angleze.

**Për Qeverinë e Republikës
Popullore të Kinës**



**Për Këshillin e Ministrave
të Republikës së Shqipërisë**

